

BASHKIA
TIRANË

MASTER PLANI I PUNËSIMIT

FALENDERIME

Master Plani i Punësimit në Bashkinë Tiranë është një dokument strategjik politikash dhe është krijuar në kuadër të projektit “Jeto Qytetin Tënd-Politikat Rinore në Nivel Lokal” me qëllim përmirësimin e politikave të punësimit dhe gjendjes aktuale të punësimit të të rinjve në Bashkinë Tiranë. E njëjta iniciativë është ndërmarrë edhe në 11 bashki të tjera të Republikës së Shqipërisë.

Falenderime të veçanta i shkojnë Fondacionit Friedrich Ebert Stiftung në Tiranë i cili ka mbështetur Kongresin Rinor Kombëtar dhe programin e dedikuar politikave rinore në nivel lokal prej tre vitesh.

Falenderime i shkojnë gjithashtu përfaqësuesve të administratës publike që morrën pjesë gjatë takimeve me fokus grupet përgjatë gjithë hartimit të Master Planit. Pa bashkëpunimin e tyre dhe ndarjen e informacioneve ky master plan nuk do të ishte i njëjti.

Falenderime shkojnë për bashkëautoren, Enxhi Lipa, koordinatorë lokale e qytetit të Tiranës, përfaqësuese e Sekretariatit të Kongresit Rinor Kombëtar. Shpreh mirënjohje gjithashtu ndaj ekspertëve të cilët asistuan 12 koordinatorët lokalë në analizimin e situatës aktuale dhe evidentimin e problematikave dhe sygjerimeve të mundshme për përmirësimin e situatës. Faleminderime kolegëve koordinatorë të cilët ndanë eksperiencat dhe kontributin e tyre gjatë gjithë këtij procesi.

Mbi të gjitha falenderime të përzemërta i shkojnë të gjithë organizatave rinore lokale pjesë apo jo e Kongresit Rinor Kombëtar, pjesëmarrësve, të rinjve, aktivistëve, studenteve dhe qytetarëve të cilët morrën pjesë dhe dhanë kontributin e tyre gjatë fazës së konceptimit dhe dizenjimit të këtij dokumenti.

Pikëpamjet e paraqitura në këtë dokument janë të Kongresit Rinor Kombëtar dhe jo domosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e Fondacionit Friedrich Ebert Stiftung.

TABELA E PËRMBAJTJES:

FALENDERIME

I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
II.	QËLLIMI DHE METODOLOGJIA	4
III.	BASHKËRENDIMI NË NIVEL LOKAL, KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR	6
IV.	PARIMET UDHËHEQËSE	7
V.	ANALIZA E SITUATËS AKTUALE TË PUNËSIMIT NË BASHKINË TIRANË	9
	V.I Pasqyra a Papunësisë	10
	Tabela 1: Shkalla e Papunësisë gjithsej	
	Tabela 2: Shkalla e Papunësisë tek të Rinjtë	
	V.II Sektori Publik	11
	V.III Sektori Privat	14
	V.IV INDIVID	17
VI.	OBJEKTIVAT	19
VII.	FUSHAT PRIORITARE	20
	ANEKSI I: ORIENTIMI DREJTË TREGUT TË PUNËS	20
	ANEKSI II: EDUKIMI DHE TRAJNIMI	14
	ANEKSI III: MUNDËSITË E PUNËSIMIT	26
	ANEKSI IV: AKSES I BARABARTË NË PUNËSIM	26
	ANEKSI V: SIPËRMARRJA	27
	ANEKSI VI: PËRMIRËSIMI I KUADRIT INSTITUCIONAL	28

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Shqipëria është një nga vendet me popullësinë më të re në rajon ku sipas të dhënave të INSTAT për vitin 2020, të rinjtë nga mosha 15-30 vjeç përfaqësojnë 30, 29 % të popullësisë. Përqendrimi më i madh i këtyre të rinjve është në qarkun e Tiranës duke e renditur si qarkun e parë me përqëndrimin më të lartë të të rinjve në vend.

Që prej themelimit të tij, Kongresit Rinor Kombëtar ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të influencuar dhe përmirësuar politikat rinore në nivel vendor dhe qendror më qëllim fuqizimin e të rinjve në 12 qarqet e vendit.

Në vitin 2017 Kongresi Rinor Kombëtar startoi së bashku me institucionet publike dhe organizatat e saj partnere procesin e konsultimit dhe hartimit të Planeve Lokale Vendore për të Rinjtë në 12 qarqet e Shqipërisë të cilat u finalizuan në vitin 2019 dhe kanë rëndësi të veçantë për zhvillimin strategjik të të rinjve në nivel vendor.

Në vijim të këtij dokumenti KRK shqyrtoi nevojën e madhe që ekziston në përmirësimin e politikave të punësimit rinor që cilësohet njëkohësisht si një ndër problematikat më të mëdha të të rinjve në vend por dhe një nga sektorët potencialë në përmirësimin e situatës aktuale.

Përgjatë gjithë vitit 2020 pavarësisht sfidave të paraqitura nga periudha e pandemisë, është punuar intensivisht me 12 Bashki për hartimin e Master Planeve të Punësimit. Ky dokument është dizenuar në kuadër të projektit “Planet Lokale të Veprimit për Rininë-Jeto Qytetin Tënd” i cili mbështetet nga Fondacioni Friedrich Ebert Stiftung në Tiranë.

II. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA

Ky dokument do të shërbejë si një dokument strategjik politikash me qëllim përmirësimin e situatës së punësimit në Bashkinë Tiranë duke përfshirë jo vetëm zonën urbane por edhe njësitë e tjera administrative dhe zonat rurale. Gjatë konceptimit dhe hartimit të këtij dokumenti janë bërë pjesë rreth 100 individë duke përfshirë këtu të rinjtë, ekspertë, studentë, aktivistë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të administratës publike, qytetarë dhe donatorë. Kampionimi i pjesëmarrësve është bërë i rastësishëm bazuar në parimin e barazisë dhe gjithëpërfshirjes.

Metodologjia e përdorur për mbledhjen e të dhënave të cilat janë integruar në këtë dokument është metodologjia e mikshuar ku përfshihen të dhëna cilësore dhe sasiore pasi janë të domosdoshme në analizimin e mirëfilltë të situatës dhe ndërtimin e politikave gjithëpërfshirëse.

Mbledhja e të dhënave është bërë në 4 faza:

Faza I: Kërkimi Paraprak


Kjo fazë përfshinë kryesisht rishikimin e burimeve parësore dhe dytësore që lidhen me punësimin në Bashkinë Tiranë. Gjatë kësaj faze janë gjeneruar më së shumti të dhëna sasiore. Këto të dhëna janë grumbulluar nga raporte zyrtare, INSTAT, publikime dhe studime mbi situatën e punësimit në Bashkinë Tiranë dhe kërkesat për informacion dërguar drejtorive përkatëse në Bashkinë Tiranë përkatësisht: Drejtorisë së Nxitjes së Punësimit, Drejtorisë së Rinisë si dhe Komisionit për Çështjet Rinore dhe Punësimit.

Faza II: Takimi me Fokus Grupet

Për grumbullimin e të dhënave cilësore është përdorur metodologjia e fokus grupeve. Janë zhvilluar 2 takime me fokus grupe të dedikuara me qëllim evidentimin e problematikave dhe gjenerimin e ideve për zgjidhjet e mundshme dhe aksionet që duhen ndërmarrë për punësimin e të rinjve në Bashkinë Tiranë. Fokusgrupi i parë përfshinë të rinjtë, studentë, aktivistë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe qytetarë të cilët janë bashkuar dhe janë bërë pjesë e takimit i cili është zhvilluar online në platformën Zoom. Fokus grupi i dytë është zhvilluar me përfaqësues të administratës publike për të marrë pikëpamjen institucionale mbi çështjen dhe për të kuptuar se ku janë nevojat për të ndërhyrë.

Faza III: Workshop Strategjik

Takimi i tretë është zhvilluar në formën e një Workshopi ku janë ftuar 5



ekspertë të fushës dhe kanë ndarë pikëpamjet e tyre për të ardhmen e tregut të punës në Shqipëri dhe aksioneve që duhen ndërmarrë për të përmirësuar tregun e punës sidomos për të rinjtë në qarkun e Tiranës. Koordinatorët lokalë janë mentoruar mbi analizimin e tregut aktual të punës, tendencat e tregut të punës në të ardhmen, barrierat e tregut aktual të punës dhe potenciali zhvillimor për të ardhmen. Sygjerimet dhe rekomandimet e marra janë bërë pjesë e këtij dokumenti.

Faza IV. Hartimi dhe Publikimi i Master Planit

Të gjithë të dhënat dhe kontributi i personave që kanë marrë pjesë në hartimin e këtij dokumenti janë integruar dhe pasqyruar me detaje gjatë seksionit të fundit të pra tek Fushat Prioritare.

III. BASHKËRENDIMI NË NIVEL LOKAL, KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR

Për të pasur një rezultat të dukshëm dhe konkret në përmirësimin e tregut të punës së të rinjve në Bashkinë Tiranë është e nevojshme koordinimi dhe bashkërendimi me strategjitë ekzistuese në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në nivel lokal ky dokument është konceptuar dhe hartuar në përputhshmëri me dokumentat ekzistues si: Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tiranë, Strategjia e Zhvillimit të Qëndrueshëm në Bashkinë Tiranë 2018-2020; Plani i Veprimit “Qytet i Gjellbër për Tiranën” dhe Plani Lokal i Veprimit për Rininë 2018-2020.

Në nivel kombëtar bazohet tek: Programi i Qeverisë 2017-2021; Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020, Strategjia për Punësim dhe Aftësi 2013-2020; Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë, Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2015-2020, Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2010-2015.

Në nivel ndërkombëtar puna bashkërendohet me: Strategjia e BE-së për Rininë Strategjia Europa 2020, Strategjia e Përfshirjes Sociale BE 2015-2020.

IV. PARIMET UDHËHEQËSE

Parimet udhëheqëse janë në përputhshmëri me strategjitë lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare të punës tek të rinjtë. Ato janë baza mbi të cilat do të hartohen dhe dizajnohen të gjitha politikat dhe aksionet e parashikuara në këtë dokument.

Përshtatja me direktivat Europian: Më hyrjen në Bashkimin Europian tregu i punës në Shqipëri do të përballet me një sërë ndryshimesh ndaj është e nevojshme të kuptojmë këto ndryshime duke filluar nga: standarti i tregut të punës, konkurrueshmëria, kuadri ligjor dhe institucional, dixhitalizimi, lëvizja e lirë e mallrave dhe standarti i produkteve dhe shërbimeve. Për këtë arsye është e rëndësishme të ndërmerim hapa që në një plan afatgjatë do të shërbejnë pikërisht këtyre ndryshimeve si dhe minimizimit të rreziqeve dhe kostove të bizneseve shqiptare dhe punonjësve shqiptarë.


Zhvillimi i Qëndrueshëm: Ky parim udhëheq çdo dokument strategjik që hartohet në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal. Menaxhimi i burimeve dhe planifikimi i integruar social dhe ekonomik janë shtyllat kryesore ku mbështetet ky parim.

Bashkërendimi: Ky master plan është hartuar duke u bashkërenduar me dokumentat strategjikë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar më qëllim harmonizimin e punës dhe zhvillimin e aktiviteteve në të mirë të interesave qytetare dhe grupeve të synuara kryesisht të rinjtë.

Punësim Cilësor për të gjithë: Ky parim synon zhvillimin e individëve duke ofruar asistencë të personalizuar në të gjitha fazat përgatitore drejt tregut të punës si dhe aftësimin dhe trajnimeve të vazhdueshme.

Gjithëpërfshirja dhe Mos-diskriminimi: Ky parim siguron përfshirjen sociale duke u fokusuar më së shumti tek grupet e marginalizuara siç janë gratë dhe vajzat, vajzat që janë viktime të dhunës, komuniteti rom dhe egjiptian, personat me aftësi të kufizuar dhe të rinjtë në zona rurale dhe emigrantët. Gjithashtu ky parim siguron mundësi të barabarta punësimi dhe kualifikimi të individëve që vijnë nga këto grupe.

Mbështetja e prodhimit vendas dhe ekonomisë lokale: Për të rritur konkurrueshmërinë në tregun europian është e rëndësishme zhvillimi i tregut lokal dhe rajonal të punës, produkteve dhe shërbimeve.



Për këtë arsye nxitja e prodhimtarisë dhe ekonomisë lokale do të shoqërohet me krijime të reja të vendeve të punës dhe uljes së papunësisë. Ky parim mbështet të gjitha nismat dhe programet që do të ndërmerren në kuadër të këtij master plani.

Zhvillimi personal dhe profesional: Ky parim synon të vendosë të rinjtë në qendër të gjithë nismave në mënyrë që të rrisë kapacitetet, njohuritë dhe aftësitë e të rinjve për tu përshtatur në vendin e punës. Ky parim do të mbështetet në ciklin e zhvillimit personal dhe profesional duke i bërë të rinjtë agjentë ndryshimi të jetës së tyre.

Bashkëpunim dhe dialog konstruktiv: Për të arritur sa më mirë përmbushjen e objektivave të këtij dokumenti është e rëndësishme bashkëpunimi me të gjithë aktorët e përfshirë si: institucionet lokale, institucionet e arsimit të lartë, institucionet e arsimit të mesëm, institucionet e arsimit profesional, komuniteti i biznesit, akademikë dhe studiues, organizatat rinore, organizatat e biznesit, sindikatat e punëtorëve dhe të rinjtë.

V. ANALIZA E SITUATËS AKTUALE TË PUNËSIMIT NË BASHKINË TIRANË

Për të arritur një mirëmenaxhim të burimeve natyrore, financiare dhe kapitalit njerëzor në nivel kombëtar dhe lokal është e nevojshme të bëhet një analizë e mirëfilltë dhe e mirëdetajuar e tregut të punës për të matur atë se çfarë kërkohet nga punëdhënësi dhe punëmarrësi në vendin e punës për të dalë me përfundime dhe rekomandime konkrete. Ajo çka duhet të theksohet është fakti se kjo analizë në shkallë kombëtare mungon çka e bënë jo të qartë për aktorët që punojnë me tregun e punës se ku duhet ti prioritizojnë fondet dhe veprimet e tyre. Mbivendosja e punës, ripërsëritja dhe kosto janë problematika që vijnë pikërisht nga kjo mungesë.

Sipas Drejtorisë së Gjendjes Civile, gjatë 2019, Bashkia Tiranë ka një sipërfaqe totale prej 1,111.00 Km² dhe një popullësi prej 842,019 banorësh në total. Prej tyre 70,60% i përkasin grupmoshës 15-64 vjeç, pra moshës që është e aftë për të punuar. Nga numri total i popullësisë 46,7% e banorëve janë nën 35 vjeç duke e renditur Tiranën si qytetin me numrin më të lartë të rinjve në vend. Femrat përbëjnë 50.5% të popullësisë totale të qytetit me një raport gjinor prej 98 meshkuj për çdo 100 femra.

Aktorët që përbëjnë tregun e punës janë të shumtë dhe dinamik megjithatë sektori privat është ai që dominon tregun si në numrin e subjekteve ashtu edhe në numrin e individëve të punësuar. Për të bërë një analizë të detajuar situatës aktuale të punësimit në Bashkinë e Tiranës dhe njësive përbërëse të saj është e nevojshme analiza e aktorëve që përbejnë tregun e punës. Për këtë arsye kjo analizë do të bazohet tek tre komponentë kryesorë: sektori publik, sektori privat dhe individi.

V.I Pasqyra a Papunësisë

Sipas Censurit të Popullësisë 2011, “Të papunë” konsiderohen personat që gjatë javës së referencës ishin: 1. pa punë gjatë javës së referencës (as nuk kishin një punë dhe as kryen ndonjë punë (për një orë ose më shumë) kundrejt një page ose përfitimi; 2. aktualisht të disponueshëm për të punuar (brenda dy javëve që pasojnë javën e referencës); 3. duke kërkuar punë në mënyrë aktive (gjatë periudhës katër javore që përfundon me javën e referencës kishin ndërmarrë hapa specifike për të kërkuar punë me pagë ose për të ngritur një biznes të tyre) ose kishin gjetur një punë që do ta fillonin së shpejti (brenda një periudhe prej të shumtën tre muaj).

Ndonëse sipas të dhënave Tirana ka përqëndrimin më të lartë të të rinjve dhe numrin më të lartë të forcës punëtore, papunësia ende mbetet një nga problematikat kryesore lidhur me çështjen e punësimit. Bazuar në Censurin e Popullësisë 2011, përqindja totale e papunësisë në Bashkinë Tiranë së bashku me NJA është 24,3%, ndërkohë që papunësia në nivel kombëtar kap shifrën prej 29,3%. Ndërkohë shifrat në lidhje me papunësinë e të rinjve ndryshojnë. Sipas po të njëjtit burim, papunësia tek të rinjtë në Tiranë është 48% pra 4,8% më e ulët se shkalla kombëtare e papunësisë së të rinjve.

Shkalla e papunësisë gjithsej




Tabela 1: Shkalla e Papunësisë gjithsej

Shkalla e papunësisë tek të rinjtë




Tabela 2: Shkalla e Papunësisë tek të Rinjtë



V.II Sektori Publik

Përsa i përket punësimit Bashkia Tiranë ka hartuar një sërë politikash ekonomike për tu ardhur në ndihmë të rinjve dhe grupeve të marginalizuara.

Programet aktuale të cilat i shërbejnë punësimit të të rinjve janë:

1. Gjimnazistët për Tiranën Inovative “Tirana Cross Cut Youth Trail”

Të rinjtë, gjimnazistët dhe studentët pajisen me metodikën e kërkimit në territorit për të krijuar instrumenta zhvillimore inovativë. Ky program i mundëson të rinjve të edukohen me ndjenjën e punës dhe me resurset natyrore të qytetit. Të rinjtë kanë mundësinë të krijojnë një shteg rinor në “Tirana Cross Cut” dhe të përfitojnë vetëpunësim si Guida Turistike në shtegun e krijuar.

2. Projekti “Fuqizimi i Grave dhe Nxitja e Sipërmarrjes III”


Ky projekt mbështet gratë sipërmarrëse duke suportuar biznese e reja dhe bizneset e vogla. Qëllimi i këtij programi është mbështetja e bizneseve të reja përmes krijimit të skemave të dhënies së granteve si dhe nxitjes së formave të ndryshme të partneritetit publik-privat. Çdo grua sipërmarrëse që kërkon të zgjerojë biznesin e saj, mund të përfitojë nga fondi i miratuar që Bashkia Tiranës do të vendosë në dispozicion. Ky program ka një rëndësi të veçantë jo vetëm për nxitjen e sipërmarrjes por edhe për fuqizimin ekonomik të grave, zbutjen e pabarazisë gjinore në vendin e punës dhe zhvillimin e ekonomisë lokale.

3. “Programi i Nxitjes së Punësimit në Ndhimë të Krijimit të Biznesit Social Rinor II”

Ky projekt përmes granteve, synon të krijojë lehtësi për ngritjen e Biznesit Social që ka sipërmarrës të rinjtë nga të gjitha kategoritë. Ky program targeton të rinjtë deri në 35 vjeç, të cilët me anë të projekteve dhe planeve të tyre të biznesit krijojnë mundësi punësimi për veten dhe të tjerët. Ky program jo vetëm synon mbështetjen e bizneseve novatore por dhe krijon mundësi gjithëpërfshirje të të rinjve dhe individëve që vijnë nga zonat rurale apo grupet e marginalizuara.

4. Projekti “Të Rinjtë Dhe Të Rejat Drejt Një Profesionit”

Ky projekt synon lehtësi për punësimin e individëve kryesisht të rinjve të sapodiplomuar me qëllim integrimin në jetën ekonomike dhe shoqërore të



vendit. Një fokus i veçantë i kushtohen të rinjve më të ardhura të pakta, atyre që u përkasin grupeve të marginalizuara, të rinjve me aftësi ndryshe dhe grave dhe vajzave. Nëpërmjet këtij programi mundësohet krijimi i vendeve të reja të punës duke bashkëpunuar me punëdhënësin. Të rinjtë kanë mundësinë të zhvillojnë një praktikë profesionale të paguar për një periudhë kohe 3-6 muaj duke u trajnuar dhe zhvilluar aftësitë e tyre si dhe duke konsoliduar marrëdhënien midis sektorit publik dhe atij privat.


5. Projekti: “Fillo me një Ide Fito një Intership në Bashkinë e Tiranës”

Ky program mbështet të gjithë të rinjtë të cilët kanë përfunduar ciklin e lartë të studimeve dhe janë deri në moshën 28 vjeç. Nëpërmjet këtij program të rinjtë mund të aplikojnë me një koncept për projekt ose studim sipas temave të caktuara në thirrje. Ky program është tre mujor dhe granti kap vlerën 66.000 lekë / personi (bruto).

Dy drejtoritë kryesore për implementimin e këtyre programave janë: Drejtoria e Nxitjes së Punësimit dhe Drejtoria e Rinisë.

Nëpërmjet këtyre programeve Drejtoria e Nxitjes së Punësimit në Bashkinë Tiranë ka asistuar 366 të rinj, prej të cilëve 201 djem dhe 165 vajza. Shtrirja gjeografike është bërë në të gjithë Qarkun e Tiranës përfshirë edhe Njësitë Administrative. Gjithashtu janë arritur të gjenerohen 48 vende të reja pune. Ndonëse Drejtoria e Rinisë ka një fokus më të gjerë se çështja e punësimit, programet dhe iniciativat e implementuara prej saj kanë një rol që lidhet më së shumti me zhvillimin e të rinjve dhe potencialit të tyre në fusha të ndryshme si: art, kulturë, sport, mjedis, turizëm, arsim dhe teknologji. Fokusi i punës së saj, i cili ka impakt indirekt në punësimin e të rinjve, është promovimi i talenteve të reja, rritja e kapaciteteve teknologjike, nxitja e inovacionit në fusha të ndryshme, zhvillimi i mendimit kritik tek të rinjtë, krijimi i projekteve pilot në komunitet, krijimi i hapësirave për diskutim të çështjeve që prekin më shumë të rinjtë dhe gjallërimi i jetës kulturore-artistike tek të rinjtë e kryeqytetit.

Ndër programet kryesore të kësaj drejtorie në periudhën 2017-2020 mund të përmendim: Biblioteka e Lagjeve si Qendra Multifunksional, Tirana Art Fest, Festivali Ndërkombëtar i Filmit/ Tirana 48 orë, Bordi Rinor, Public Speaking, Stand up Comedy, Festivali Letrar, Krijë poezinë tënde, Biblioteka Merr dhe Jep, Dhurimi i Librave, Festivali i Teatrit, Edukimi Mjedisor për të Rinjtë, Dita Kombëtare e Rinisë-8 Dhjetori; Earth Hour Tirana; Dita Ndërkombëtare e Rinisë-12 Gusht, Dita Ndërkombëtare e Vullnetarëve, Të rinjtë kundër korrupsionit dhe Shqipëria e së Ardhmes-seri e Debateve Parlamentare me të Rinjtë.



Target grupi i synuar i të gjitha programeve të lartë përmendura është kryesisht moshë 15-30 vjeç pa pasur dallim gjinie midis femrave dhe meshkujve. Në aspektin gjinor edhe pse vajzat dhe gratë favorizohen me programe të dedikuara për to, në fakt pjesëmarrja e tyre është më e lartë edhe në programet e tjera në krahasim me meshkujt. Përveç shifrave, ky perceptim vjen edhe nga përfaqësues të administratës publike të cilët gjatë takimeve të zhvilluara kanë vënë theksin tek kjo dukuri.

Përsa i përket kapaciteteve dhe programeve që i dedikohen punësimit të të rinjve nga pikëpamja institucionale duhet theksuar fakti se Bashkia Tiranë është e para dhe e vetmja bashki në Republikën e Shqipërisë e cila përveç dokumentave strategjikë, drejtorive të dedikuara për rininë dhe nxitjen e punësimit ka gjithashtu edhe një buxhet të dedikuar për rininë. Lidhur me buxhetin që i dedikohet Drejtorisë së Rinisë shifrat tregojnë se ky buxhet është 4-fishuar nga viti 2015-2020.

Në tre vitet e fundit ky buxhet ka qenë:


- o 2018 – 15 milion Leke të reja
- o 2019 – 15 milion Lekë të reja
- o 2020 – 20 milion Lekë të reja

E njëjta situatë paraqitet edhe në Drejtorinë e Nxitjes së Punësimit. Buxheti i alokuar për “Programin e Nxitjes së Punësimit të Biznesit Rinor” është në vlerën 20.000.000 lekë, ndërkohë që programi “Të Rinjtë dhe të Rejat Drejtë një Profesion” ka një fond prej 7.100.000 lekësh.

Përveç programeve të nxitjes së punësimit të të rinjve, një tjetër rol i drejtorive që kanë në fokus punësimin ose lidhen indirekt me të është ndërmjetësimi i personave të papunë në tregun e punës. Sipas të dhënave të INSTAT, numri i personave të ndërmjetësuar në tregun e punës është 720. Në vitin 2019 kjo shifër shkon në 300 persona, prej të cilëve 117 femra dhe 183 meshkuj. Të ndara sipas grupmoshës 57 persona i përkasin moshës 18-25 vjeç, 156 persona moshës 25-40 vjeç dhe 87 persona mbi 40 vjeç.

Të dhënat për vitin 2020 i përkasin vetëm gjashtë mujorit të parë të vitit ku totali i personave të ndërmjetësuar është 136 persona në total. Prej tyre 42 janë femra dhe 94 meshkuj. Ndarë sipas grupmoshës: 24 individë janë midis moshës 18-25 vjeç, 34 persona në moshën 25-40 vjeç dhe 78 mbi 40 vjeç.

Sektorët kryesorë ku këto individë janë ndërmjetësuar janë: teknologji e informacionit dhe komunikimit, ndërtim, industri fasone, shërbime dhe tregti.



Një tjetër risi nga pikëpamja institucionale në Bashkinë Tiranë është themelimi i Zyrës së Karrirës. Bashkia Tiranë dhe RisiAlbania kanë dakortësuar një memorandum bashkëpunimi mbi zhvillimin e shërbimit të karrierës si shërbim i ofruar nga Bashkia e Tiranës për ti shërbyer të rinjve dhe të rejave. Vizioni i Bashkisë së Tiranës është që ti ofrojë të rinjve dhe të rejave një shërbim efektiv për këshillimin e karrierës, në mënyrë që ata të marrin vendime të mirë-informuara për karrierën e tyre arsimore, kualifikuese dhe punësimin.

Hapi i parë për zhvillimin e shërbimit të karrierës, ka qenë zhvillimi i modelit të ofrimit të shërbimit. Ky model përveçse ofron një kornizë të përgjithshme të shërbimit dhe grupeve të synuara, përmbledh dhe shpjegon shërbimet dhe mënyrat e ofrimit të këtyre shërbimeve nga Zyra e Karrierës – Bashkia Tiranë.

Shërbimet e parashikuara përfshijnë: infoteke fizike dhe virtuale, bashkëbisedim i shkurtër, seanca individuale të orientimit profesional (60-90 minuta), seanca informimi dhe këshillimi në grup, veprimtari tematike të hapura, ndërmjetesimi i praktikave, organizimi i panairëve të punës dhe profesioneve dhe veprimtari promovuese ad hoc.

V.III Sektori Privat

Përqëndrimi i bizneseve në qarkun e Tiranës është padyshim më i lartë se në çdo qark tjetër. Në fund të vitit 2019, numri i bizneseve aktive në vend ishte 162342. Nga këto 28,6% e bizneseve të vendit janë të përqëndruara në Bashkinë Tiranë. Sipas të dhënave të marra nga Drejtori e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore (DPTTV) në tremujorin e 2020 numërohen gjithsej 50,211 subjekte aktive në Tiranë. Po të shohim trendin e bizneseve në Bashkinë Tiranë shohim se ka një tendencë rritëse nga viti në vit. Sipas të dhënave vihet re rritja e peshës së numrit të bizneseve në njësitë administrative rurale dukë përbërë 15,35% të bizneseve që operojnë në Tiranë krahasuar me 12,03% në vitin 2016.

Sipas të dhënave në 2019 nga pikëpamja gjinore, 74.62% e bizneseve aktive në Republikën e Shqipërisë administrohen nga meshkuj, ndërkohë që vetëm 25,38 administrohen nga femra. Në Bashkinë Tiranë shifrat tregojnë se sektori privat ende ka një dominancë të gjinisë mashkullore pasi 66.35% e bizneseve aktive në Tiranë administrohen nga meshkuj dhe 33,65% nga femra.


Sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore (DPTTV) në lidhje me situatën e bizneseve të reja në Bashkinë Tiranë gjatë vitit 2019 janë regjistruar gjithsej 7299 subjekte. Tabelat e mëposhtme përmbledhin këto subjekte sipas kategorive.

SUBJEKTE KRYESORE	SUBJEKTE
Shitje me pakicë	2476
Shitje me shumicë	558
Njësi prodhimi	207
Subjekte ndërtimi	177
Njësi shërbimi	3197
Shoqata, fondacione, ente, organizata	36
Profesione të lira	535
Transport	110
Ambulant	3
Të tjera	0
Totali	7299

Ndërkohë që për vitin 2020 të dhënat paraqiten vetëm për tre tremujoret e parë të vitit. Edhe pse ky vit ka qenë një vit i vështirë pandemik për tre muajt e parë numërohen 4834 subjekte të reja. Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat për 2020.

SUBJEKTE KRYESORE	SUBJEKTE
Shitje me pakicë	1125
Shitje me shumicë	390
Njësi prodhimi	151
Subjekte ndërtimi	171
Njësi shërbimi	2215
Shoqata, fondacione, ente, organizata	16
Profesione të lira	327
Transport	58
Ambulant	3
Të tjera	0
Totali	4834





Sektori privat gjithashtu gjeneron edhe numrin me të lartë të të punësuarve jo vetëm në Bashkinë e Tiranës por në të gjithë vendin. Sipas raportit të Drejtorisë së Nxitjes së Punësimit gjatë vitit 2018 subjektet private të cilat kanë shpallur pozicione vakante kanë qenë 120. Ndërkohë ky numër pothuaj është dyfishuar në vitin 2019 dhe arrin 230 vende vakante. Ndër këto 19 vende vakante janë shpallur në sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, 18 vende vakantë në ndërtim, 11 vende vakante në industri, 85 vende vakante në sektorin e shërbimeve dhe 32 vende vakante në tregti.

Për vitin 2020 shifrat e raportuara i përkasin vetëm gjashtë mujorit të parë ku figurojnë gjithsej 91 pozicione të lira pune. Nga këto: 5 janë në sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, 7 në ndërtim, 9 në industri, 23 në sektorin e shërbimeve dhe 12 në tregt

V.IV INDIVIDIDI

Në të dhënat e gjeneruara nga INSTAT në Anketën e Forcave të Punës (AFP), **“Të Punësuar”** janë konsideruar personat që kanë kryer një punë qoftë dhe një orë kundrejt një page ose përfitimi gjatë javës së referencës. Janë konsideruar si të punësuar edhe personat që marrin pagë për trajnimin gjatë punës.

Të papunë konsiderohen personat që gjatë javës së referencës ishin: 1. pa punë gjatë javës së referencës (as nuk kishin një punë dhe as kryen ndonjë punë (për një orë ose më shumë) kundrejt një page ose përfitimi; 2. aktualisht të disponueshëm për të punuar (brenda dy javëve që pasojnë javën e referencës); 3. duke kërkuar punë në mënyrë aktive (gjatë periudhës katër javore që përfundon me javën e referencës kishin ndërmarrë hapa specifike për të kërkuar punë me pagë ose për të ngritur një biznes të tyrin) ose kishin gjetur një punë që do ta fillonin së shpejti (brenda një periudhe prej të shumtën tre muaj).

Popullsia në moshë pune është popullsia 15-64 vjeç.

Forca e Punës përfshin personat e punësuar dhe të papunë.

Shkalla e punësimit është raporti i të punësuarve 15-64 vjeç kundrejt popullsisë në moshë pune.


Shkalla e papunësisë është raporti i të papunëve kundrejt forcës së punës.

Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës është raporti i forcës së punës kundrejt popullsisë në moshë pune.

Lidhur me situatën e individëve në rang kombëtar, bazuar në vlerësimet e Anketës së Forcave të Punës 2019, numri i personave në forcën e punës ishte 1430 mijë persona. Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës për popullësinë 15-63 vjeç është 69,6%. Ndërkohë, shkalla e punësimit për popullësinë 15-64 vjeç është 61,2 %.

Për Bashkinë Tiranë të dhënat mbi punëkërkuarit e papunë për vitin 2018 paraqesin në total 800 punëkërkuar apo aplikantë. Nga këto në gjashtë mujorin e parë të viti janë regjistruar 195 persona të komunitetit Rom dhe Egjiptianë. Ndërkohë numri i ofertave të punës është 600 dhe numri i subjekteve private ofertuese 120. Në total janë ndërmjetësuar 720 individë dhe janë punësuar 153 prej tyre.





Situata e punëkërkesve të papunë paraqitet në rënie në 2019 ku numri total i regjistruar është 490. Nga këto 279 janë meshkuj dhe 211 janë femra. Kërkesa ka pasur edhe nga grupet e marginalizuara ku 41 individë janë regjistruar nga komuniteti Rom dhe 6 nga personat me aftësi të kufizuara (PAK). Oferta pune rezultojnë në total 450 dhe subjekte private ofertuese 230. Në total janë ndërmjetësuar 300 individë dhe janë punësuar 68 prej tyre.

Për vitin 2020 të dhënat zyrtare të publikuara i përkasin vetëm gjashtë mujorit të parë të vitit. Nga këto të dhëna regjistrohen në total 37 punëkërkes. Oferta pune në total janë 372 dhe subjekte private ofertuese 45. Në total janë ndërmjetësuar 91 individë dhe janë punësuar 136. Sektorët e punësimit janë të ndryshëm por për vitin 2019, në qarkun e Tiranës, punësimi në bujqësi zë një përqindje shumë të vogël të punësimit gjithsej (7,3 %). Pjesa më e madhe e të punësuarve janë të angazhuar në sektorin e shërbimeve (66,3 %) dhe një peshë të konsiderueshme zë edhe industria (26,3 %).

VI. OBJEKTIVAT

Objektivat e këtij Master Plani janë si më poshtë:

1. Të krijojë një kuadër cilësor politikash për punësimin dhe dinjitetin e të rinjve.
2. Të formojë të rinjtë si agjent ndryshimi të situatës së tyre drejtë integritimit në tregun e punës.
3. Të ofrojë asistencë të personalizuar në zhvillimin personal të të rinjve dhe mundësive të karrierës në Tiranë dhe NJA.
4. Të përmirësojë integrimin dhe qëndrueshmërinë e të rinjve në tregun e punës nëpërmjet zhvillimit personal dhe profesional dhe kualifikimeve të vazhdueshme.
5. Zhvillimi i ekonomisë lokale nëpërmjet promovimit të ekonomisë qarkulluese dhe biznesit social dhe biznesit të gjelbër.
6. Rritja e aksesueshmërisë së tregut të punës dhe programeve të aftësimin për grupet e marginalizuara dhe gratë dhe vajzat.
7. Të sigurojë përmirësimin e situatës së barazisë gjinore në tregun e punës dhe mundësi të barabarta të punësimit dhe zhvillimit profesional.
8. Të rrisë bashkëpunimin midis aktorëve publik dhe privat që operojnë në fushën e punësimit, zhvillimit të karrierës dhe kualifikimeve profesionale.

VII. FUSHAT PRIORITARE

Për të arritur përmbushjen e objektivave të lartë përmendura ky Master Plan parashikon 6 prioritete kryesore së bashku me objektivat strategjikë, propozimet e iniciativave dhe aksionet që mund të ndërmerren për të ndërhyrë dhe për të përmirësuar situatën. Prioritizimi i aksioneve që do të ndërmerren në vitet pasardhëse kryesisht për reduktimin e numrit të rinjve të papunë, përmirësimin e cilësisë së forcës punëtore, fasilitimin drejt vendit të punës dhe zvogëlimin e hendekut gjinor në tregun e punës.

Gjashtë fushat prioritare janë:

1. Orientimi drejt Tregut të Punës
2. Edukimi dhe Trajnimi
3. Mundësitë e Punësimit
4. Akses i Barabartë në Punësim
5. Sipërmarrja
6. Përmirësimi i kuadrit Institucional


ANEKSI I: ORIENTIMI DREJTË TREGUT TË PUNËS

Qëllimi kryesor: Informimi, orientimi profesional, motivimi, këshillimi, diagnostifikimi dhe përcaktimi i profilit të karrierës përfshirë këtu edhe kompetencat, kërkimi për një vend pune dhe ndërmjetësimi në tregun e punës.

OBJEKTIVI 1: Këshillimi i Karrierës dhe Asistencë e Personalizuar

Këshillimi i karrierës është një fazë shumë e rëndësishme e cila i paraprin fazave pasardhëse për kërkimin e vendit të punës. Kjo fazë është e lidhur ngushtë me zhvillimin personal të individëve dhe formimin e tyre të përgjithshëm dhe akademik. Gjithashtu kjo fazë i shërben individëve të riorganizojnë dhe të mire-menaxhojnë burimet e tyre, njohuritë dhe aftësitë për një kërkim më efikas të mundësive aktuale të punësimit në Bashkinë Tiranë por dhe për zhvillimin e mundësive të reja në këtë territor. Duke qenë se Bashkia Tiranë ka ndërtuar shërbimin e Këshillimit të Karrierës në Drejtorinë e Nxitjes së Punësimit, aksionet e propozuara janë





me qëllim komplementimin e punës së kësaj strukture dhe zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve që ajo përmban.

Aksioni 1: Formimi i Grupit Këshillimor të Karrierës

Sfida e realizimit të një analize të mirëfilltë të tregut të punës sjell me vete vështirësi për të kuptuar realisht cilat janë nevojat e punëkërkuësve dhe punëmarrësve në tregun e punës në Shqipëri. Kjo është një sfidë në nivel kombëtar dhe lokal i cili ka nevojë për një ndërhyrje sa më të shpejtë.


Formimi i Grupit Këshillimor të Karrierës synon më tej formimin e një grupi prej 100 individësh në nivel lokal të kualifikuar specifikisht për orientimin dhe këshillimin e të rinjve. Ky hap përfshin këshillim të personalizuar të individëve sidomos të rinjve duke u bazuar tek interesat, aftësitë e tyre, nevojën e tregut të punës dhe politikat shtetërore. Ajo çka e lidh këtë grup me analizën e tregut të punës është pikërisht analizimi i nevojave specifike të punëkërkuësve dhe fasilitimi i tyre në procesin e zhvillimit personal dhe profesional.

Puna e Grupit Këshillimor të Karrierës do të komplementohet nga një grup Ndërmjetësuesish Rinorë të cilët do të vijnë nga organizatat rinore dhe ekspertë të jashtëm.

Grupi Këshillimor i Karrierës do të hartojë një Program Individual Orientimi i cili do të përfshijë: diagnostifikimin personal, planin personal të zhvillimit dhe planin personal të trajnimit dhe kualifikimit. Në mënyrë që të zhvillohet ky program është e rëndësishme që grupi i këshilluesve të trajnohet paraprakisht dhe të pajiset më informacionin dhe aftësitë e duhura për të përmbushur me sukses fazën e parë. Ky grup duhet të përfshijë ekspertë të fushës, punonjës të burimeve njerëzore, trajnerë dhe mentorë lidhur me zhvillimin personal dhe profesional, përfaqësues nga organizata rinore dhe nga institucionet e përfshira në hartimin e këtij programi si dhe përfaqësues nga institucionet arsimore dhe komuniteti i biznesit. Hartimi i këtij program do të mbështetet në parimin e gjithëpërfshirjes dhe mos-diskriminimit.

Aksioni 2: Diagnostifikimi dhe Programi Individual i Orientimit Drejt Tregut të Punës

Kualifikimi i forcës punëtore dhe mospërputhja midis aftësive dhe edukimit formal mbetet një nga arsyet kryesore të numrit të lartë të papunësisë tek të rinjtë. Për këtë arsye është e rëndësishme krijimi i një programi që do të analizojë nevojat specifike, njohuritë dhe aftësitë në nivel individual. Hapi i parë i këtij programi do të jetë diagnostifikimi individual dhe ndërtimi i një profili personal që do të përfshijë: aftësitë, kompetencat, eksperiencat, trajnimet, interesat, gjendjen aktuale në familje dhe mundësitë e karrierës. Ky informacion do të përdoret në momentin e krijimit të planit të zhvillimit personal dhe profesional si dhe klasifikimin në bazë të nevojave të tregut të



punës. Plani i Zhvillimit Personal dhe Profesional do të dizenjohej së bashku me punëkërkesin dhe për këtë arsye është e nevojshme të nënshkruhet një dakortësim midis tij dhe Zyrës së Karrierës në Bashkinë Tiranë me qëllim mbrojtjen e përdorimit të të dhënave si dhe sigurimin e vazhdimësisë në hapat pasardhës deri në momentin e punësimit.

Ky plan do përfshijë:

1. Identifikimin e nevojave për krijimin e planit të zhvillimit personal bazuar në parimet europiane me synim formimin e qytetarëve të ardhshëm europian të përgjegjshëm dhe të ndërgjegjësuar më integrimin në tregun ndërkombëtar të punës
2. Identifikimin e mundësive të karrierës në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar
3. Identifikimin e nevojave për krijimin e planit të zhvillimit profesional duke përfshirë eksperiencat e mëparshme në tregun e punës si dhe trajnimet dhe kualifikimet sipas metodës jo-formale të edukimit.
4. Njohjen me të drejtat e individit në tregun e punës si dhe njohjen me legjislacionin në fuqi për tregun e punës në Shqipëri dhe Europë.
5. Kërkimi i vendeve aktive të punës dhe asistencë deri në momentin e punësimit
6. Pajisja e individëve me njohuri bazike dhe të avancuara përsa i përket hapave të kërkimit të vendit të punës.
7. Ngritje kapacitetesh në aftësitë e buta (soft skills), aftësi dixhitale dhe aftësi që lidhen me vendin e punës si përsëmbull: krijimi i një curriculum vitae, komunikimi, mendimi analitik, puna në grup, menaxhimi i kohës dhe stresit në vendin e punës, siguria në punë dhe krijimi i profilit personal në platforma dixhitale që lidhen me rrjetëzimin profesional siç është LinkedIn.

Aksioni 3: Formimi i Grupit të Ndërmjetësuesve Rinorë

Ndërmjetësuesit Rinorë do të jenë një grup i cili do të asistojë drejtpërdrejtë në punën e Grupit Këshillimor të Karrierës dhe do të përcjellin tek ta zërin e të rinjve. Anasjelltas ata gjithashtu do të komunikojnë punën e grupit Këshillimor të Karrierës tek qytetarët dhe rrjetet e tyre për të përhapur në këtë mënyrë informacionin. Ata do të asistojnë të gjitha aktivitetet dhe do të kenë si detyrë kryesore komunikimin dhe vizibilitetin e brendshëm dhe të jashtëm të këtyre aktiviteteve. Ky grup do të përbëhet nga përfaqësues nga organizatat dhe qendrat rinore, përfaqësues nga shërbimi kombëtar i rinisë, përfaqësues nga sindikatat e punëtorëve, grupimeve informale

rinore, si dhe përfaqësues nga grupet e marginalizuara.

Aksioni 4: Këshillim Gjithëpërfshires i të Rinjve Që Vijnë Nga Zonat Rurale, Gratë, Vajzat, Komunitete të Ndryshme në Shqipëri si dhe Personat me Aftësi Të Kufizuar.

Programi Individual i Orientimit do të kushtojë rëndësi të veçantë të rinjve që vijnë nga zonat rurale dhe grupet e marginalizuara. Duke qenë se numri i papunësisë është më i lartë tek këta individë dhe aksesueshmëria e informacionit dhe lokacioneve për mundësi zhvillimi dhe trajnimi është më e vështirë atëherë lind nevoja që zhvillimi i aktiviteteve që do të përmbajë ky program të kryhet pranë zonave ku këta të rinj të kenë akses.

OBJEKTIVI 2: Raporti me Aktorët e Tregut të Punës

Aksioni 1: Ngritje e Kapaciteteve dhe Rrjetëzim

Një objektiv tjetër i Programit Individual të Orientimit do të jetë dhe krijimi i urave lidhëse midis aktorëve të ndryshëm që janë pjesë aktive e tregut të punës. Këtu përfshihen institucionet arsimore të arsimit të lartë, arsimit të mesëm dhe arsimit profesional, agjensitë shtetërore lidhur me punësimin, komuniteti i biznesit dhe organizatat e shoqërisë civile.

Ky aksion parashikon takime dhe trajnime të përbashkëta të aktorëve të përfshirë kryesisht rreth zhvillimit të qëndrueshëm të tregut të punës dhe një qasjeje më miqësore për të rinjtë në formën e praktikave, punës në distancë apo teorisë dhe praktikës së integruar.

Gjithashtu është e nevojshme të trajnohet komuniteti i biznesit me qasjen europiane dhe aftësinë për të rritur konkurrueshmërinë në tregun europian. Aftësia për tu përshtatur me ndryshimet që do të pësojë ky komunitet me hyrjen në BE mund të krijojë hapësira për punësimin dhe integrimin e të rinjve në strukturat e tyre.



ANEKSI II: EDUKIMI DHE TRAJNIMI

Fusha e edukimit dhe trajnimit është një fushë shumë e gjerë dhe Tirana ndonëse ofron mundësi dhe aktorë që punojnë intensivisht në këtë fushë është e rëndësishme të theksohet se duke qenë se tregu është në lëvizje të vazhdueshme nevoja për trajnime dhe kualifikime është gjithmonë prezente.

OBJEKTIVI 1: Përmirësimi i Forcës Punëtore të Kompanive dhe Bizneseve

Kapitali njerëzor është një nga asetet më të çmuara të një biznesi dhe është gjithashtu një kapital i cili ka në dorë jetëgjatësinë dhe prezencën e një biznesi në tregun e punës. Me këtë nënkuptojmë se në nivel liderशिpi vendimet që drejtuesit marrin për bizneset apo punonjësit e tyre përcaktojnë edhe të ardhmen e një biznesi. Duke qenë se tregu i punës është i ndryshueshëm i ndikuar më së shumti nga faktori demografik, klimatik, politik dhe teknologjik nevoja për të përshtatur kapitalin njerëzor me këto ndryshime është thelbësore në qëndrueshmërinë e një biznesi. Me integrimin në BE, Shqipëria do të pësojë ndryshime në shumë fusha dhe komuniteti i biznesit është ai që ka një rrezikshmëri të lartë nëse liderët e bizneseve nuk ndërgjëgjësohen dhe informohen në lidhje me këto ndryshime. Konkurrenca, standartet e reja, formalitete dhe zhvillimi i aftësive janë disa nga sfidat kryesore.

Aksioni 1: Krijimi i Mundësive për Kualifikime Profesionale Dhe Zhvillimi i Aftësive që Lidhen me Tregun e Punës

Aftësitë e buta (soft skills), gjuhët e huaja, aftësitë dixhitale janë ato aftësi të cilat para 10 viteve konsideroheshin një aset më shumë në profilin profesional të individëve. Në tregun e sotshëm ato shihen si standarte bazë dhe kërkohen nga çdo punëdhënës. Për këtë arsye është e nevojshme zhvillimi i kurseve dhe kompeticioneve në nivel lokal lidhur më fusha si: debati dhe dialogu konstruktiv, muzika, arti, kodimi, dizenjimi, sporti etj.

Aksioni 2: Marrëveshje Bashkëpunimi Midis Shkollave dhe Bizneseve

Për të rritur shancin e punësimit është e rëndësishme një bashkëpunim i ngushtë midis shkollave dhe bizneseve. Përshtatja e metodologjisë mësimore dhe anën praktike do të shoqërohet me një impakt shumë pozitiv dhe tek të rinjtë pasi do kenë mundësi të testojnë njohuritë e tyre në praktikë por dhe të kuptojnë se si funksionon tregu i punës.



OBJEKTIVI 2: Suport drejt Tranzicionit në Tregun e Punës nëpërmjet zhvillimit të Aftë-sive dhe Kompetencave

Për të rritur shancet për integrimin në tregun e punës është e nevojshme që fuqia punëtore të njohë shumë mirë si funksionon tregu, si ndryshon dhe se si ata mund të përshtaten më këto ndryshime. Në këtë objektivi fokusi kryesor do të jetë zhvillimi i kompetencave bazë jo vetëm për të përmbushur një CV të pasur por edhe për të rritur konkurrueshmërinë në tregun e punës. Ne propozojmë që aksionet për të përmbushur këtë objektivi të hartohen në formën e Programit për Ngjitjen e Kapaciteteve dhe Zhvillimit të Kompetencave. Ky program mund të inkorporohet dhe të komplementojë shërbimin e Këshillimit të Karrierës në Bashkinë Tiranë. Aksionet e propozuara në kuadër të këtij program janë:

Aksioni 1: Trajnime mbi kompetencat bazë

Aksioni 2: Trajnime mbi kompetencat dixhitale

Aksioni 3: Trajnime mbi gjuhët e huaja dhe mundësitë e mobilitetit për studime dhe punë

Aksioni 4: Trajnime në sektorët strategjik kryesisht lidhur me aspektin profesional

Aksioni 5: Trajnime në bujqësi, blegori dhe agroturizëm si potencial për zhvillimin ekonomik në nivel lokal

Aksioni 6: Programe bursash për studentët në vështirësi ekonomike që dëshirojnë të vazhdojnë studimet e larta

Aksioni 7: Trajnime për inovacionin në edukim dhe trajnim

Aksioni 8: Trajnime midis brezave të ndryshëm për shkëmbim informacioni dhe kompetencash

Aksioni 9: Trajnime për stafet e bizneseve apo institucioneve për asistimin e grupeve të marginalizuara në tregun e punës dhe gjithëpërfshirjen.



ANEKSI III: MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Ky aneks i dedikohet kryesisht grupeve të marginalizuara në mënyrë që të nxisë punëdhënësit të punësojnë, krijojnë hapësira dhe të mbajnë në punë individë të cilët kanë vështirësi në ndërrimin e punës dhe gjenden në situatë ku kanë nevojë për suport ekonomik. Këtu përfshihen kryesisht personat më aftësi të kufizuar, gratë viktime të dhunës, emigrantët, viktime të terrorizmit apo të rinjtë që kanë probleme në familje dhe strehohen në qendra sociale.

Të rinjtë kryesisht janë më të pasigurtë pasi mund të bien më lehtësisht pre e abuzimeve dhe të përjashtohen nga aksesueshmëria në vendin e punës.

Ky aneks synon përmbushjen e objektivave si më poshtë:

OBJEKTIVI I: Rritja e Aksesueshmërisë në Tregun e Punës

Aksioni 1: Krijimi i një rrjeti të konsoliduar midis shkollave-institucioneve-biznesit

Aksioni 2: Portal online dhe databasë e punëkërkuesve dhe punëmarrësve

Aksioni 3: Programi mbështetës për grupet vulnerabël

Aksioni 4: Projekte Pilot mbështetur në ekonominë qarkulluese dhe ekonominë e gjelbërt

Aksioni 5: Programi për suportin dhe promovimin e talenteve

ANEKSI IV: AKSES I BARABARTË NË PUNËSIM

Bazuar në parimin e gjithëpërfshirjes ky aneks synon krijimin e mundësive të barabarta për individët dhe sidomos të rinjtë që vijnë nga shtresat e varfra, komuniteti rom, aftësia e kufizuar, zonat rurale dhe gratë dhe vajzat si dhe viktimat e dhunës në familje.



Aksioni 1: Krijimi i bashkëpunimit me aktorët që punojnë me barazinë gjinore

Aksioni 2: Programi i start-upeve për gratë dhe vajzat në teknologji

Aksioni 3: Programi i mbështetjes së grave dhe vajzave në zonat rurale

Aksioni 4: Programi i mbështetjes së grupeve të marginalizuara nëpërmjet mbështetjes ekonomike për ide inovatore apo ide vetëpunësimi

ANEKSI V: SIPËRMARRJA

Ky aksion lidhet ngushtë me aktivitete që promovojnë sipërmarrjen, vetë-punësimin dhe bizneset sociale me qëllim zhvillimin e ekonomisë lokale në qendër dhe zonat rurale të Tiranës. Programet do të lidhen kryesisht me dhënien e granteve dhe krijimit të një grupi donatorësh që të sigurojnë qëndrueshmërinë e fondeve në fushën e sipërmarrjes.

OBJEKTIVI 1: Promovimi i Sipërmarrjes

Aksioni 1: Krijimi i Një Rrjeti Donatorësh

Ky rrjet do të shërbejë për krijimin e një fondi të veçantë pranë Bashkisë Tiranë me synim dhënien e granteve dhe subvencioneve për projektet lidhur me sipërmarrjen rinore

Aksioni 2: Inkubatori i Biznesit

Në mënyrë që bizneset të sigurojnë qëndrueshmëri dhe rritje në tregun e punës është e rëndësishme të formohet Inkubatori i Biznesit si qendër e rëndësishme për suportin e vazhdueshëm të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe start-upeve në sektorë të ndryshëm.

OBJEKTIVI 2: Trajnim dhe Këshillim i Specializuar për Bizneset dhe Sipërmarrësit

Aksioni 1: Trajnime dhe Certifikime Profesionale

Sektorë të ndryshëm kanë zhvillime të ndryshme dhe për pasojë kanë nevojë të ndryshme për tu trajnuar. Për të përmbushur këtë objektiv është



e rëndësishme hartimi i trajnimeve në sektorë strategjikë për liderët e bizneseve dhe më pas për punonjësit e tyre.

OBJEKTIVI 3: Promovimi i Bizneseve Lokale dhe Brandeve Shqiptare

Për të rritur konkurrueshmërinë në tregun kombëtar dhe rajonal është e rëndësishme zhvillimi i brendshëm i ekonomisë në mënyrë të qëndrueshme. Për ti shërbyer kësaj objektivë i duhet dhënë një shtysë bizneseve lokale sidomos atyre në zonat rurale me fokus në: turizëm, bujqësi, blegtori, artizatat dhe kulinari.

Aksioni 1: Zhvillimi i Panairit të Biznesit Lokal

Ky panair do të zhvillohet me të gjithë bizneset që janë të interesuara të promovojnë produktet dhe shërbimet e tyre si dhe të paraqesin mundësitë e punësimit tek të rinjtë.

OBJEKTIVI 4: Bashkëpunim midis Aktorëve që Punojnë në Sektorët Strategjikë të Sipërmarrjes dhe Vetëpunësimit

Aksioni 1: Rrjetëzimi

Rrjetëzimi është gjithmonë një mundësi e mirë që bizneset të zgjerojnë tregun e tyre dhe të rrisin mundësitë e bashkëpunimit. Për këtë arsye është e rëndësishme të nënshkruhen marrëveshje bashkëpunimi midis institucioneve lokale dhe bizneseve lokale ose midis dy bizneseve lokale me qëllim zhvillimin e projekteve të përbashkëta.

ANEKSI VI: PËRMIRËSIMI I KUADRIT INSTITUCIONAL

Në nivel lokal është e rëndësishme që institucionet të luajnë një rol rregullator dhe fasilitues midis aktorëve.

Aksioni 1: Krijimi i një Platforme Online të Punësimit

Kjo platformë do të përmbajë krijimin e një profili individual të të rinjve bazuar në Programin Individual të Orientimit. Aty mund të postohen njoftime nga punëkërkuarit dhe punëmarrësit si dhe mundësi mobiliteti me rajonin dhe vendet e Europës.





Aksioni 2: Fasilitimi në Shkëmbimin e Informacionit

Ky aksion do të shërbejë në shkëmbimin e informacionit midis aktorëve që punojnë në fushën e punësimit duke i përfshirë ato në thirrje për projekte dhe iniciativa inovatore.

Aksioni 3: Të Nxisin Projektet Pilot me Donator nga Bizneset Lokale

Mbështetja e bizneseve më njëri tjetrin është një frymë e mirë e cila kultivon jo vetëm përfitimet financiare por dhe krijon një klimë më të butë dhe më oportuniste për të rinjtë. Ky aksion parashikon dhënien e donacioneve nga bizneset e mëdha kundrejtë bizneseve më të vogla apo individë me ide inovatore kryesisht atyre në zonat rurale.

